



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 17, Date 28.09 2011

PËR

ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË PUNËTORËVE TË LËVIZSHËM NË
AVIACIONIN CIVIL

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në përputhje me Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit”,

UDHËZOJ :

Neni 1

1. Qellimi i këtij udhezimi është rregullimi në Republikën e Shqipërisë, i kohës së punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.
2. Në përputhje me këtë udhezim sipermarrjet e aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë, do të zbatohen rregullat e vendosura në Marrëveshjen Evropiane mbi organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil të arritur më 22 Mars 2000 ndërmjet organizatave përfaqësuese të drejtuesve dhe fuqisë punëtore në sektorin e aviacionit civil të cilat janë:
 - Organizata e Linjave Ajrore Evropiane (SHLAE),
 - Federata e Punëtorëve Evropian të Transportit (FPET),
 - Shoqata Evropiane Kabina/Cockpit (SHEK),
 - Shoqata Evropiane e Linjave Rajonale (SHEL R),
 - Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajror (SHNTA),

Rregullat specifike mbi te cilat eshte arritur marreveshja jane paraqitur ne shtojcen bashkelidhur ketij udhezimi, e cila eshte pjese integrale e tij.

Neni 2

1. Sipermarret e aviacionit civil mund të ruajnë ose zbatojne rregulla më të favorshme se ato të përcaktuara në këtë Udhezim.
2. Zbatimi i ketij udhezimi ne asnje rrethane nuk perben baze te mjaftueshme per te justifikuar një reduktim ne nivelin e pergjithshem te mbrojtjes se punetoreve ne fushat e mbuluara nga ky udhezim.
3. Zbatimi i ketij udhezimi nuk cenon te drejten e organeve kompetente, drejtuesve apo fuqise punetore qe, ne rrethana te ndryshme, te percaktojne masa legjislative, rregulluese, ose kontraktuale te vecanta nga ato te vendosura ne kete udhezim, me kusht qe gjithmonë kërkesat minimale të përcaktuara në këtë udhezim të zbatohen.

Neni 3

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil qe brenda dates 1 Shtator 2012 te marre masat e nevojshme per zbatimin e ketij udhezimi ne sektorin e aviacionit civil.

Neni 4

Ky udhezim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR

SHTOJCE

Ne perputhje me parashikimet e Marrëveshjes Europiane mbi organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil të arritur më 22 Mars 2000 ndërmjet organizatave përfaqësuese të drejtuesve dhe fuqisë punëtore në sektorin e aviacionit civil: Organizata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata e Punëtorëve Europian të Transportit (FPET), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajror (SHNTA), ne Republikën e Shqipërisë do të zbatohen rregullat dhe percaktimet si mëposhte:

- 1.1 Keto rregulla zbatohen për kohën e punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.
- 1.2 Kjo Shtojce permban rregulla me specifike brenda kuptimit të legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë, lidhur me kohën e punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.
 - 2.1 “*kohë pune*” nënkupton çdo periudhë gjatë së cilës i punësuar punon, në dispozicion të punëdhënësit duke kryer detyrat dhe aktivitetet e tij, në përputhje me ligjet kombëtare.
 - 2.2 “*stafi i lëvizshëm në aviacionin civil*” nënkupton anëtarët e ekuipazhit në një avion civil, të punësuar nga një sipërmarrje të krijuar në Republikën e Shqipërisë ose në një Shtet Anëtar të ZPEA-se.
 - 2.3 “*koha e fluturimit bllok*” nënkupton kohën ndërmjet lëvizjes së parë të një avioni nga vendi i tij i parkimit, me qëllim ngritjen, derisa ai kthehet për të pushuar në vendin e parkimit të përcaktuar dhe deri sa të gjithë motorët të kenë ndaluar.
- 3.1 Staf i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e lejës vjetore të paguar prej katër javësh të paktën sipas kushteve të dhënies së të drejtës të një leje të tillë të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar.
- 3.2 Koha minimale e lejës vjetore të paguar nuk mund të zëvendësohet me një ndihmë financiare në vend të saj, përjashto rastin kur marrëdhënies së punësimit i jepet fund.
 - 4.1.1 Staf i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e kontrollit shëndetësor falas para marrjes së detyrës dhe më vonë gjatë intervaleve të rregullta.
 - 4.1.2 Staf i lëvizshëm në aviacionin civil i cili vuan nga probleme shëndetsore që dihet se kanë lidhje me faktin se ata punojnë natën, do të transferohen kur të jetë e mundshme në ditë pune të lëvizshme ose të palëvizshme në të cilën ata përshtaten.
- 4.2 Kontrolli shëndetësor falas i përmëndur në paragrafin 4.1.1 pajtohet me konfidencialitetin mjekësor.
- 4.3 Kontrolli shëndetësor falas i përmëndur në paragrafin 4.1.1 mund të realizohet brenda sistemit shëndetsor kombëtar.
- 5.1 Staf i lëvizshëm në aviacionin civil do të ketë mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë sipas natyrës së punës.

- 5.2 Mbrojtja e duhur dhe shërbime parandaluese ose lehtësuese lidhur me shëndetin dhe sigurinë e stafit të lëvizshëm në aviacionin civil do të jenë në dispozicion gjatë gjithë kohës.
6. Masa të nevojshme do të ndërmerren për të siguruar se një punëdhënës, i cili ka për qëllim të organizojë punën sipas një sistemi të caktuar, merr në konsideratë parimin e përgjithshëm të përshtatjes së punës.
7. Të dhënat lidhur me sistemet specifike të punës të punonjësve të lëvizshme në aviacionin civil i sigurohen autoriteteve kompetente nëse ato e kërkojnë këtë.
- 8.1 Koha vjetore maksimale e punës, duke përfshirë disa elemente të zëvendësimit për caktim me detyrë siç përcaktohet nga ligji në fuqi, përbëhet nga 2000 orë në të cilën koha bllok e fluturimit është e kufizuar në 900 orë.
- 8.2 Koha vjetore maksimale e punës shpërndahet sa më e barabartë dhe praktike gjatë gjithë vitit.
9. Pa cënuar pikën 3, stafit të lëvizshëm në aviacionin civil, i jepen dite të lira nga çdo lloj detyre dhe zëvendësimi, të cilat i njoftohen para kohe, si më poshtë:
 - a) të paktën shtatë ditë lokale në çdo muaj kalendarik të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushim të parashikuar me ligj; dhe
 - b) të paktën 96 ditë lokale çdo vit kalendarik, të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushim të parashikuar me ligj.